




Agjencia për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, po vazhdon aktivitetet e veta lidhur me mbështetjen e biznesit dhe zhvillimin ekonomik në vend. Një nga këto projekte është edhe Parku i Biznesit në Drenas. Parku i Biznesit në Drenas, tanimë ka një infrastrukturë fizike të kompletuar dhe është e gatshme për shfrytëzim. Faza e parë e aplikimit të bizneseve ka përfunduar, është bërë përzgjedhja e bizneseve dhe janë nënshkruar kontratat.

Parku i Biznesit në Drenas në kapacitetet e veta ka edhe një numër të ngastrave të lira për këtë qëllim Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, shpall:

KONKURS

FAZA E DYTË E APLIKIMIT

Vendosja e Bizneseve në “Parkun e Biznesit në Drenas”



Ku gjendet Parku i Biznesit në Drenas



Parku i Biznesit në Drenas shtrihet në kilometrin e 22-të përgjatë magjstrales Prishtinë - Pejë, në fshatin Koreticë e Epërme. Në një diametër prej 80 km mbulon çdo cep të kufirit të Kosovës ndërsa në një diametër prej 400 Km ka qasje në korridoret rrugore kryesore pan-evropian nr. 4, 5, 8, 9 dhe 10 si dhe në qytetet kryesore të rajonit: Selanik, Tiranë, Durrës, Shkup, Sofje, Beograd, Zagreb, Sarajevë dhe Podgoricë.

Çka ofron Parku i Biznesit në Drenas

Parku ofron një vend ideal me infrastrukturë të kompletuar dhe shërbime kualitative. Parku i Biznesit ka një sipërfaqe prej 24 ha dhe do të jetë pjesë e një zone të ardhshme industriale me mbi 130 ha. Parku i Biznesit në Drenas ofron lokacione të madhësive të ndryshme për biznese, kryesisht për sektorë të prodhimit dhe shërbimeve. Çdo ngastër ka qasje direkte në rrugët kryesore të Parkut si dhe ka kycjen individuale në rrjetin kryesor të parkut me kanalizim, ujë të pijes dhe atë industrial, gas, nxemje, telefoni, internet, etj.

Kush mund të aplikojë

Të gjitha bizneset e interesuara, vendore apo të huaja të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret që i ka përcaktuar Bordi i projektit si dhe kanë programe atraktive në funksion të nxitjes së krijimit të vendeve të reja të punës, zvogëlimit të varfërisë dhe rritjes ekonomike.

Tërheqja e aplikacioneve

Dokumenti “Kushtet dhe Kriteret për vendosje të kompanive në PBD” dhe Aplikacionet mund të tërhiqen duke vizituar njërin nga web faqet e poshtë shënuara:

<http://www.mti-ks.org>

<http://www.sme-ks.org>

<http://www.invest-ks.org>

ose në zyrën qendrore të Agjencisë për mbështetje të NVM në, në adresën e poshtëshënuar.

Adresa: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme,

Zyra nr. 16, Rr. “Muharrem Fejza” p.n , Lagja e Spitalit

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Ku duhet dorëzuar aplikacionet

Formularët e plotësuar për konkurrim dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm mund të dërgohen në mënyrë elektronike në e-mailin zyrtar të Agjencisë për mbështetje të NVM-ve.

sme.nvm@ks-gov.net

me mbishkrim **Aplikacion për Park të Biznesit**

ose

duke sjellur aplikacionet fizikisht në zyrën qendrore të Agjencisë për mbështetje të NVM te

Znj. Lirija Medunjanin (tel. +38 /0/ 38 200 36 570)

Vërejtje

Në çfarëdo forme që dërgoni materialet kërkoni dëshminë e pranimit të aplikimit tuaj.

Afati i konkurrimit është: 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në shtypin ditor

Për çdo paqartësi apo informatë shtesë mund të drejtoheni në adresën: sme.nvm@ks-gov.net